



**RREGULLORE PËR KONTROLLIN E CILËSISË DHE
DHËNIEN E SIGURISË PËR SHËRBIMET E KRYERA NGA KONTABILISTET E
MIRATUAR**

Te pergjithshme

Kontabilisti i Miratuar është një profesionist i pavarur, i cili e ushtron veprimtarinë profesionale ne perputhje me kerkesat e ligjit 10091 dt. 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të EKR dhe KM” i ndryshuar me ligjin 47/2016 date 28/04/2016.

Anëtar i IKM është një Kontabilist i Miratuar i cili ka pranuar vullnetarisht kërkesat e statutit të IKM.

Komiteti i Kontrollit është një organizëm i krijuar në përmbushje të detyrimeve statutore për mbikqyrjen dhe monitorimin e cilësisë së angazhimevetë anëtarëve të IKM. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë monitoron përmes zbatimit të rregullave dhe standardeve profesionale dhe të etikës, kryerjen e angazhimeve profesionale të tyre.

Këshilli Drejtues ka miratuar këto rregulla që do të drejtojnë kontrollin e cilësisë dhe dhënien e sigurisë për shërbimet e kryera nga Kontabilistët e Miratuar.

Neni 1.
Qëllimi

Për të garantuar cilësinë e angazhimeve profesionale të anëtarëve IKM, ngrihet dhe funksionon sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë, i cili përfshin: kontrollin e cilësisë në nivel angazhimi individual të kontabilistit, si dhe kontrollin e cilësisë, për shërbimet e ofruara nga shoqëritë e kontabilistëve..

Kontrolli i Cilësisë që organizohet nga IKM, është një procedurë e shqyrtimit nga Këshilli Drejtues i saj, në lidhje me veprimtarinë profesionale të një kontabilisti të miratuar dhe të shoqërive (firmave) të kontabilitetit vendase dhe të huaja, anëtare të IKM. Këshilli Drejtues, ndërton procedurat dhe realizon kontrollin e cilësisë bazuar, në Statutin e IKM, në këtë rregullore dhe në pajtim me kërkesa të tjera të shpjeguara në Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë nr. 1.

Kontrolli i Cilësisë, ka për qëllim të verifikojë dhe të japë siguri të mjaftueshme se Kontabilisti i Miratuar dhe shoqëritë e kontabilitetit anëtare të IKM, gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe kryerjes së shërbimeve profesionale, respektojnë kërkesat ligjore dhe rregullat e tjera të brendëshme të Institutit dhe se organizimi i firmave të kontabilitetit ju përgjigjet nevojave të ushtrimit të profesionit.

Kontrolli për cilësinë organizohet në mënyrë të atillë që të jetë i pavarur.

Neni 2.
Detyrimi për kontroll



Kontrolli i Cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët të IKM.

Anëtarët që refuzojnë t'i nënshtrohen këtij kontrolli, bëjnë një shkelje të rregullave të parashikuara në Kodin e Etikës të IKM dhe i nënshtrohen procedurave disiplinore.

Kontrolli i Cilësisë, kryhet pranë vendndodhjeve të subjektit që do të kontrollohet ose në raste të caktuara edhe pranë zyrave të IKM. Kontrolli për cilësinë shtrihet mbi tërësinë e organizimit dhe të veprimtarisë profesionale së kontabilistit, dhe të shoqërisë së kontabilitetit.

Neni 3. **Kontrolli i cilësisë**

Kontrolli i Cilësisë realizohet përmes kontrollit të shërbimeve të kontabilitetit, rishikimit dhe dhënien e sigurve të tjera, të përzgjedhura nga ana e Komitetit të Cilësisë dhe përfshin një vlerësim të pajtueshmërisë me standardet e zbatueshme të kontabilitetit, me kërkesat e etikës dhe të pavarësisë, dhe një vlerësim të cilësisë dhe sasisë së burimeve të shpenzuara, të tarifave të përdorura.

Në përfundim të kontrollit, nga Kontrolluesi i Cilësisë përgatitet një raport, i cili përmban gjetjet faktike dhe konkluzionet kryesore të arritura gjatë kryerjes së kontrollit. Ky raport i paraqitet Komitetit të Cilësisë. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet kontrolluesit dhe të kontrolluarit, arbitrimi bëhet nga Komiteti i Cilësisë, pasi subjekti i kontrolluar ka paraqitur, formalisht, qëndrimin i tij.

Kontrolli i Cilësisë kryhet për cdo anëtar brenda 3 vjeteve pas çertifikimit, si dhe të paktën një herë në çdo 5 (pesë) vjet pas kontrollit të parë .

Neni 4. **Ekspertët Kontrollues**

- Kontrolli i Cilësisë kryhet nga ekspertet kontrollues, të cilët janë Kontabilistë të Miratuar anëtar të IKM-së. Përzgjedhja e kontrollorëve për kontrollin e cilësisë bëhet nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë, në bazë të një procedure objektive, e cila jep garanci se nuk ka konflikt interesash ndërmjet kontrollorit dhe subjektit kontabël ose shoqërisë, që do të kontrollohet.

Procedura e përzgjedhjes së kontrolluesve është e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Drejtimit. Këshillit Drejtues vendos për kriteret e përzgjedhjes së fondit të anëtareve që mund të veprojnë si kontrollues. Kriteret mund të ndryshohen përsëri ndërmjet ndryshimeve të miratuara nga Komiteti Drejtues. N

Në fazën e dytë bëhet pastaj përzgjedhja behet rastesore brenda këtij fondi.

Qe nje anetar i IKM te behet anetar I Fondit te Kontabilistëve te Miratuar duhet te plotesoje keto kriteret:

- 5 vjet experience ne ushtrimin e profesionit
- Te kete marre pjese ne kualifikimet e vijueshme te pakten gjate 3 viteve te fundit.
- Cdo dege mbi 10 anetar duhet te kete te pakten nje anetar tek Fondi I Kontrollorëve
- Një kontrollor nuk mund të shërbejë më shumë se 5 vite rradhazi.

Neni 5.

Organizmi i Komitetit të Cilësisë

Për organizimin dhe drejtimin e kontrollit të cilësisë krijohet Komiteti i Kontrollit të Cilësisë, i cili përbëhet nga 3 Kontabilistë të Miratuar anëtarë të IKM, me përvojë dhe emër të mirë. Anëtarët e Komitetit të Cilësisë mund të vijnë edhe nga bota akademike, ose nga autoritetet mbikëqyrëse të sektorëve të rregulluar të ekonomisë.

Anëtarët e Komitetit të Cilësisë zgjidhen nga asamblea e anëtarësisë së IKM, për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Ata mund të ricaktohen, por jo më shumë se edhe një mandat tjetër. Pozicioni i kryetarit dhe zëvendës kryetarit të Këshillit Drejtues të IKM është i papajftueshëm me funksionin e anëtarit të Komitetit të Cilësisë.

Neni 6.

Detyrat e Komitetit të Cilësisë

Komiteti i Cilësisë ka këto të drejta e detyra kryesore:

- Të implementojë dhe të ruajë sistemet e përshtatshme për kontrollin e cilësisë
- Harton procedurat që do të zbatohen për të përzgjedhur anëtarët që do të nënshtrohen kontrollit të cilësisë, të cilat miratohen nga këshilli drejtues i IKM
- Harton udhëzues pune (manual) për kontrollin, bazuar në udhëzimet e publikuara nga Federata ndërkombëtare e Kontabilistëve, i cili miratohet nga Këshilli drejtues.
- Harton programin vjetor të kontrollit të cilësisë, i cili miratohet nga Këshilli Drejtues i IKM. Programi duhet të paraqitet pranë Komitetit Drejtues brenda Dhjetorit të vitit paraardhës.
- Harton dhe propozon procedurat e përzgjedhjes së ekspertëve kontrollues; të cilat miratohen nga këshilli drejtues i IKM
- Përgatit dhe azhuron tematikën e kontrollit të cilësisë;
- Përcakton periodicitetin e kontrollit si dhe kohën e nevojshme për çdo kontroll;
- Përcakton koston e kontroleve dhe mënyrën e përballimit të koston;
- Merr materialet dhe konkluzionet e grupeve të ekspertëve kontrollues dhe bazuar në rezultatet e kontrollit organizon mbrojtjen e materialeve për disa prej anëtarëve të kontrolluar.
- Përgatit vlerësimet paraprake për përfundimet e rezultateve të kontrollit dhe ia komunikon ato Këshillit Drejtues;
- Harton Modelin e Raportit në lidhje me Kontrollin e cilësisë të kryer së bashku me anekset përkatëse , të cilat i paraqiten për miratim Këshillit Drejtues;
- Bën propozime dhe rekomandime për masat që duhen marrë ndaj KM.
- Raporton në Asambleenë e Përgjithëshme për kontrollet e ushtruara midis dy mbledhjeve të rradhës.
- Harton module trajnimi dhe informimi për anëtarët e shoqatës lidhur me rëndësinë e të kuptuarit dhe të aplikuarit të kontrollit të cilësisë në nivel anetari të IKM;
-

Neni 7.

Afatet

Kontrolli i cilësisë duhet të kryhet në afatet e përcaktuara në kalendarin e miratuar nga Këshilli Drejtues dhe në pajtim me programin e kontrollit të miratuar nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë.

Eksperti kontrollues duhet të përmbushë detyrën e tij në mënyrë të pavarur. Kontrollori do të kryejë verifikimet që i gjykon të nevojshme dhe do të bëjë rekomandimet që i çmon të dobishme. Në rastin e rikontrolleve, do të ndiqen të njëjtat procedura që zbatohen edhe për kontrollin, por në këto raste kontrolli do të kryhet pranë Institutit.

Eksperti kontrollues ka të drejtën e hyrjes në çdo informacion, që ai e gjykon të nevojshëm për kryerjen e misionit të kontrollit, të përdorë pyetsorë (manuali i kontrollit) dhe të kërkojë sqarime. Eksperti kontrollues duhet të vërë në dukje, kur është rasti, se nuk ka pasur të drejtë hyrje në të gjithë informacionin e nevojshëm.

Në përfundim të kontrollit të cilësisë eksperti/tët kontrollues hartojnë një Raport i cili i paraqitet Komitetit të Kontrollit të Cilësisë për shqyrtim.

Komitetit të Kontrollit të Cilësisë thërret dhe dëgjon për mbrojtje të dosjeve anëtarët e kontrolluar dhe shoqëritë perkatese në prani dhe të kontrolluesve sa herë që ai e gjykon të arsyeshme bazuar në rezultatet e kontrollit. **Brenda nje periudhe 30 (tridhjet) ditore pas mbylljese se afatit te periudhes se kontrollit cdo të kontrolluari i lind e drejtat e ankimit**

Neni 8.

Raportimi

Raporti i ekspertit/tët kontrollues duhet të përmbajë të paktën informacionet për këto çështje:

- a) mënyrën dhe procedurën se si është kryer kontrolli;
- b) një përshkrim dhe vlerësim të përgjithshëm të strukturës dhe aktivitetit të Kontabilistit të Miratuar ose shoqërisë, si dhe çdo informacion tjetër lidhur me organizimin e shoqërisë, i cili lidhet me nevojën për të vlerësuar ndërtimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm të cilësisë,
- c) një përshkrim të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit dhe realizimit të shërbimeve nga anëtari ose shoqëria e kontrolluar.
- d) shkeljet e ligjit, të rregullave dhe të standardeve të profesionit që janë konstatuar nga kontrolli;
- e) dobësitë dhe neglizhencat e konstatuara. Gjithashtu do të bëhen kontrollet e nevojshme për detyrate lëna nga aktkontrolli para-ardhës.

f) rekomandimet për anëtarin e kontrolluar dhe për IKM, për veprimet që priten të ndërmerren nga ky i fundit në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Neni 9.

Vlerësimi

Raportet dhe dokumentet e ekspertëve ose të ekipeve të ekspertëve kontrollues shqyrtohen nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë. Mbi bazën e këtij vlerësimi Komiteti përgatit vlerësimin përfundimtar mbi kontrollin e cilësisë.

Komiteti i Cilësisë bën përmbledhjen e kontrolleve të kryera dhe të përfundimeve e rekomandimeve të bëra në raportin e kontrolleve dhe ia paraqet ato Këshillit Drejtues.

Vetëm Këshilli Drejtues ka të drejtë të zyrtarizojë përfundimet e kontrolleve, të kërkojë zbatimin e rekomandimeve. Ai për shkelje që janë subjekt i masave disiplinore vendos masat e disiplinore që parashikon statuti i IKM.

Vlerësimi i kontrollit të jetë me 4 shkallë :

- **Dobët**
- **Mjaftueshëm**
- **Mirë**
- **Shumë mirë**

Çdo shkallë vlerësimi mbështetet në tregues lehtësisht të kuptueshëm. Proçedurat e ndjekura gjatë kontrollit nga kontrollorët mbështeten në plotësimin e manualit të kontrollit. Ata që rikontrollohen përballojnë kostot e kontrollit.

Neni 10.

Sekreti Profesional

Kontrolli i Cilësisë dhe kryerja e angazhimeve kërkojnë respektimin rigoroz të sekretit profesional si nga ana e kontrolluesit ashtu edhe nga ai i kontrolluar.

Informimi i të tretëve, direkt ose indirekt të faktit që Kontabilisti i Miratuar, dhe/ose shoqëria i është nenshtuar detyrimit të kontrollit, dhe/ose të raportit të përgatitur e të përfunduar të kontrollit, përbën një shkelje të rregullave të etikës profesionale dhe ndëshkohet nga proçedurat disiplinore.

Raportet e kontrollit dhe cdo dokument tjetër që lidhet me kontrollet janë dokumenta të brendshëm të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar dhe përmbajtja e tyre nuk mund të përhapet tek të tretët.



Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqiperisë
Albanian Institute of Certified Accountants

Rezultatet e përgjithshme të sistemit të kontrollit të cilësisë publikohen çdo vit nga IKM, në mënyrë të përmblodhur dhe pa përmendur emrat e veçantë.

Rekomandimet e Komitetit të Kontrollit të Cilësisë duhet të ndiqen nga anëtarët për t'u zbatuar brenda një periudhe kohe të arsyeshme.

Maj 2018

Kryetari i Keshillit të Drejtimit

Prof.Dr. Sotiraq DHAMO